

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7888
E shtunë, 21 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Kurti takon drejtorin e përgjithshëm për Zgjerim të BE-së, zotohet për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOORDINATORJA E KOMITETEVE NË VETËVENDOSJE, DEJONA MIHALI, INTERVISTOHET NGA PROKURORIA SPECIALE

 | FAQE 4-5

Dejona Mihali, koordinatoresh e fuqishme e Komitetëve në Lëvizjen Vetëvendosje, është intervistuar të premten nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Në një njoftim Prokuroria Speciale ka bërë me dije se Mihali është intervistuar në cilësinë e

dëshmitares për disa çështje penale që po hetohen nga kjo prokurori. Pas përfundimit të intervistimit, Mihali u është përgjigjur shkurt pyetjeve të gazetarëve. "Jam intervistuar për zbardhjen e së vërtetës...", ka

thënë ajo, e cila nga gazetarët është pyetur edhe për mesazhet e saj me ish-kryeshëfin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, por nuk ka dhënë përgjigje. "Gjithë të mirat! Mirupafshim! Punë të mbarë!", tha Mihali

MBROJTJA E SELIMIT KËRKON NGA PROKURORIA TË MOS NDIKOJË NË DËSHMITARË GJATË SEANCEVE PËRGATITORE | F. 4



NGA VITI I ARDHSHËM RRRUGËT E KRYEQYTETIT DO TË JENË ME SHIRIT TË VEÇANTË PËR AUTOBUSË | F. 3



OPINION

SHTATË PIKAT E VUÇIQIT DHE MARRËVESHJA E BRUKSELIT | F. 7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



SHEJA E BE-së NJOFTON PËR HUAN PREJ 39 MILIARDË DOLLARËSH PËR RIMËKËMBJEN E UKRAINËS | F. 2

PJETËR SHALA: KEMI GJETUR FJALI TË NDRYSHUARA GJATË PËRKTHIMEVE, NUK E DI SE NË ÇFARË MËNYRE JAM DËNUAR | F. 5

EKONOMI



GUVERNATORI I BQK-së TAKON PËRFAQËSUESIN E THESARIT TË SHBA-së, FLASIN PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT | F. 8

ABRASHI: KOSOVA KA REGRES EKONOMIK, POLITIKA PO NDIKON NEGATIVISHT NË PROJEKTET MADHORE | F. 8

SPORT



PRISHTINA DEKLASON DUKAGJININ, SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE TË TJERA NË SUPERLIGË | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kurti takon drejtorin e përgjithshëm për Zgjerim të BE-së, zotohet për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit

EPOKA E RE

Lirim GECI

BRUKSEL, 20 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti u prit të premten në Bruksel nga drejtori i përgjithshëm për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Gert Jan Koopman, me të cilin diskutoi për aspektet e shumta të procesit të integritimit të Kosovës në BE, përfshirë perspektivën për avancimin e kandidaturës për anëtarësim në kontekstin aktual evropian.

Në takim u trajtuan edhe çështje të tjera të ndërlidhura me procesin e zgjerimit të BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mes të cilave edhe për nevojën e funksionalizimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, mbi parimet e pjesëmarrjes së barabartë për të gjitha shtetet e rajonit.

Kryeministri Kurti tha se Kosova është e interesuar që Tregu i Përbashkët Rajonal të funksionalizohet, sidomos tani kur shënohet 10-vjetori i Procesit të Berlinit dhe shtoi se kjo duhet arritur duke avancuar në drejtimin e afrimit të rajonit me standardet evropiane, si ato në fushën e ekonomisë, ashtu edhe ato në fushën e demokracisë dhe

sundimit të ligjit.

Ai theksoi se për Kosovën pengesat aktuale në progresin e saj kanë të bëjnë me situatën e sigurisë dhe kërcënimin e vazhdueshëm që vjen nga Serbia, dhe të cilin tha se Kosova kërkon ta adresojë në bashkëpunim me partnerët perëndimorë, pikërisht për shkak të lidhjeve shumta dhe të ngushta të Serbisë me Rusinë.

Në takim, po ashtu, u diskutua edhe fillimi i zbatimit të Planit të Rritjes, si instrument i Komisionit Evropian i krijuar për t'i dhënë shtysë të madhe afrimit sa më të shpejtë dhe përmbajtësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në.

Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, që është proces i ndarë por, që ka ndikim në zgjerimin e BE-së, kryeministri Kurti tha se Republika e Kosovës vazhdimisht ka qenë palë konstruktive dhe se e ka në interes përmblyjen e këtij procesi. Në këtë kuptim, kryeministri ia ka konfirmuar drejtorit Koopman qëndrimin në mbështetje të Marrëveshjes Bazë dhe Planit Zbatues, të arritura vitin e kaluar. "Kosova me këtë riafirmim përkushtimin e saj për procesin e normalizimit të marrëdhënieve



në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe zotohet për angazhim konstruktiv në proces për ta çuar atë shpejt përpara. Në këtë kontekst, Kosova zotohet që plotësisht t'i zbatojë të gjitha obligimet respektive që dalin nga Marrëveshja Bazike për Rrugën Drejt Normalizimit dhe Aneksi Zbatues i saj, përfshirë aty të gjitha

marrëveshjet e kaluara të dialogut. Detajet e implementimit do të diskutohen në dialog në lehtësimin e BE-së", tha kryeministri Kurti. Ndërsa drejtori i përgjithshëm Koopman porositi se përkushtimi i institucioneve evropiane në Bruksel për integritimin e Kosovës dhe tërë rajonit të Ballkanit

Perëndimor në BE është i fortë dhe do të vazhdojë të jetë i tillë edhe me përbërjen e ardhshme të Komisionit Evropian, një gjë që është dëshmuar edhe me qëndrimet e shprehura nga presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, në drekën e djeshme me liderët e Ballkanit Perëndimor.

Shefja e BE-së njofton për huan prej 39 miliardë dollarësh për rimëkëmbjen e Ukrainës

BRUKSEL, 20 SHTATOR - Komisioni Evropian do t'ia ndajë Ukrainës një hua të re në vlerë 39 miliardë dollarë, njoftoi presidentja e komisionit, Ursula von der Leyen, gjatë një vizite në Kiev më 20 shtator. Ajo e cilësoi këtë hua si "një kontribut tjetër i madh i BE-së për rimëkëmbjen e Ukrainës". "Sulmet e paarshtura ruse nënkuptojnë se Ukraina ka nevojë për mbështetjen e vazhdueshme të BE-së", shkroi ajo në rrjetin social X.

Duke folur në një konferencë për media me von der Leyen, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se "plani për fitore" i vendit të tij në luftën kundër Rusisë varet nga vendimet e



shpejta që aleatët duhet t'i marrin sivjet. Zelensky tha se Ukraina synon t'i

përdorë këto të holla për mbrojtjen ajrore, energjinë dhe për blerjen e armëve.

Huaja është pjesë e një plani të gjerë të Grupit të Shtatë (G7) shteteve më të industrializuara për grumbullimin e të hollave për ta mbështetur Kievin duke i përdorur mjetet nga asetet e ngrira financiare të Rusisë në vlerë 300 miliardë dollarë. Këto asete u ngrinë në kuadër të sanksioneve kundër Moskës për pushtimin e Ukrainës. Vizita e Von der Leyen në kryeqytetin ukrainas vjen një ditë pasi ajo njoftoi se BE-ja do t'ia japë Ukrainës edhe 178 milionë dollarë për ta riparuar infrastrukturën e dëmtuar të energjisë, ta zgjerojë energjinë e ripërtërishme dhe të ndërtojë strehimore. Para takimit me Zelenskyn, ajo tha se ndodhej në Kiev për të biseduar

për mbështetjen e Evropës për Ukrainën "nga përgatitjet për dimër deri te mbrojtja, anëtarësimi dhe përparimi drejt huave prej G7".

Në fillim të kësaj jave Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) paralajmëroi se ky dimër mund të jetë më i vështirë për Ukrainën deri tani, sepse infrastruktura energjetike e saj është tejet e tendosur si pasojë e sulmeve ruse ndaj termocentraleve, ngritësve dhe rrjetit energjetik. Forcat ajrore ukrainase thanë më 20 shtator se kundërajrorët e tyre i shkatërruan 61 prej 70 dronëve dhe një prej katër raketave me të cilat Moskë e sulmoi Ukrainën gjatë natës.

Franca, buzë formimit të qeverisë së re

Paris, 20 shtator - Pas disa muajve pasiguri politike pas zgjedhjeve të parakohshme, duket se Franca është shumë afër ta ketë qeverinë e re, pasi kryeministri Michel Barnier pritët ta paraqesë kabinetin para presidentit Emmanuel Macron.

Macron e emëroi Barnierin kryeministër të vendit para dy javëve. Barnier, ish-kryenegociator i BE-së për Brexit-in, ka hasur në vështirësi për ta formuar qeverinë e re për shkak të dallimeve të mëdha mes partive politike. Zgjedhjet e parakohshme të

thirrura nga Macroni në korrik nuk dhanë fitues të qartë, i cili do të mund ta formonte qeverinë e re vetë, duke e lënë Francën në duart e një qeverie të përkohshme. Tani i takon Macronit ta miratojë kabinetin e Barnierit.



Koordinatorja e komiteteve në Vetëvendosje, Dejana Mihali, intervistohet nga Prokuroria Speciale

Dejana Mihali, koordinatorja e fuqishme e Komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje, është intervistuar të premten nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Në një njoftim Prokuroria Speciale ka bërë me dije se Mihali është intervistuar në cilësinë e dëshmitares për disa çështje penale që po hetohen nga kjo prokurori. Pas përfundimit të intervistimit, Mihali u është përgjigjur shkurt pyetjeve të gazetarëve. “Jam intervistuar për zbardhjen e së vërtetës...”, ka thënë ajo, e cila nga gazetarët është pyetur edhe për mesazhet e saj me ish-kryeshefin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, por nuk ka dhënë përgjigje. “Gjithë të mirat! Mirupafshim! Punë të mbarë!”, tha Mihali

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Dejana Mihali, koordinatorja e komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje, është paraqitur të premten në Prokurorinë Speciale me ftesë të kësaj prokurorie.

Mihali është intervistuar në cilësinë e dëshmitares për disa çështje penale, të cilat kjo prokurori i ka në hetim. “Pas interesimit për të marrë informacion nga një numër i madh i gazetarëve, Prokuroria Speciale informon se sot Dejana Mihali është paraqitur në Prokurorinë Speciale me ftesë të kësaj prokurorie. E njëjta është duke u intervistuar në cilësinë e dëshmitares për disa çështje penale, të cilat kjo prokurori i ka në hetim”, ka njoftuar Prokuroria Speciale.

Pas përfundimit të intervistimit, ajo u është përgjigjur shkurt pyetjeve të gazetarëve. “Jam intervistuar për zbardhjen e së vërtetës...”, ka thënë ajo. E pyetur nga gazetarët për cilën të vërtetë është fjala, ajo tha “duhet ta pyesni Prokurorinë”.

Mihali më tutje u pyet për mesazhet e saj me ish-kryeshefin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, por nuk

u përgjigj. “Gjithë të mirat! Mirupafshim! Punë të mbarë!”, ishte fjalia e Mihalit.

Për intervistimin e Mihalit ka reaguar opozita.

Sekretari për Anëtarësi dhe Financa i Partisë Demokratike të Kosovës, Betim Gjoshi, ka thënë se zori i madh i Vetëvendosjes, që përmes ligjeve ta kapë Prokurorinë e Shtetit, nuk paska qenë “lufta kundër korrupsionit”, por “luftë për mundësimin e korrupsionit”. “Duart e Dejana Mihalit në korrupsion e tenderë milionësh, janë në të vërtetë duart e Albin Kurtit. Fjalimet me sulme të ashpra të Albin Kurtit mbi prokurorët dhe gjykatësit, paskan qenë paralajmërimi për prokurorë dhe gjykatësit që njerëzit e tij të vjedhin me duar të lira. Albin Kurtit i duhet një Prokurori ku akuzat i shkruan dhe i përgatit bashkë me Dejana Mihalit dhe jo një Prokurori që e shkruan akuzën e tyre”, ka shkruar Gjoshi në “Facebook”.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, duke reaguar ndaj kësaj ngjarjeje, ka thënë se po i ngushtohet rrethi mafisë energjetike. “Veprimet e fundit të drejtësisë në Kosovë po i japin shpresë popullit për fuqinë e ligjit

mbi të gjithë. Mafia energjetike duhet të përballet me ligjin. Shteti ligjor dhe demokracia nuk dorëzohen para strukturave të dyshimta kriminale. Po i ngushtohet rrethi”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, ishte shumë i shkurtër në komentin e tij rreth intervistimit të Dejana Mihalit. “Krimi ka emër”, ka shkruar Gashi në “Facebook”.

Edhe anëtarë i kryesisë së Nismës, Zafir Berisha, ka komentuar

intervistimin e Mihalit, duke thënë se “edhe 15 kate me bë Dubravën, nuk ka me i zënë këta hajdutë”. “Komisarja politike e VV-së Dejana Mihali, po intervistohet sot në Prokurorinë Speciale për korrupsion të nivelit të lartë, ku janë në pyetje miliona ero. Edhe 15 kate me bë Dubravën nuk ka për t'i zënë këta hajdut ordinerë, të cilën në mënyrë të pamëshirshme po i vjedhin parat e qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar Berisha në “Facebook”. Ndërsa analistët e ndryshëm

politikë kanë përdorur disa slogane të kamotshme të LV-së, duke i akuzuar me to partinë në pushtet. “Jo veç Dejana Mihali, po krejt këtë pushtet aktual keni më e pa duke u intervistuar nëpër prokurori e gjykata. Krejt për korrupsion, hajni e nepotizëm. Edhe me e ba Dubravën 12 kate, k'ta s'ka me i zanë”, ka shkruar analisti Ilir Mirena.

Mediet në vazhdimësi kanë raportuar për ndikimin e madh që ka Dejana Mihali në LV dhe në pushtetin e sotëm të Albin Kurtit.

Nga viti i ardhshëm rrugët e kryeqytetit do të jenë me shirit të veçantë për autobusë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Nga viti i ardhshëm rrugët e kryeqytetit do të kenë shirit të veçantë vetëm për autobusë të trafikut urban. Kështu u tha në diskutimin e mbajtur nga organizata INDEP në kuadër të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës (KSDW) 2024.

Diskutimet u fokusuan në nevojën për një zgjidhje të qëndrueshme për lëvizshmërinë e qytetarëve me një transport inovativ dhe me miqësor për mjedisin.

Gent Sejdiu, menaxher i projektit për reformën e transportit publik urban të komunës së Prishtinës, ka thënë se komuna ka hartuar Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të

Prishtinës, i cili parasheh reformat për këtë çështje.

Ai ka thënë se qeverisja ka bërë reforma në transportin publik, ku me këtë rast ka folur edhe për ndryshimet që priten të bëhen nga viti i ardhshëm, duke shtuar se nga viti 2025 disa rrugë në kryeqytet do të përdoren vetëm nga autobusët.

“Aktivitetet që kemi mbajtur kanë qenë të koncentruara në tri fokuse: shfrytëzimi i transportit publik, lëvizja e lirë dhe ciklizmi. Në fokus kemi pasur vetëdijësimin e qytetarëve. Në fokus kanë qenë fëmijët. Ideja është që ne si fokus të përgjithshëm në nivel kombëtar të bëjmë sa më shumë investim të fëmijët që të kuptojnë se pse duhet ta përdorin



transportin publik, biçikletat. Qeverisja e re ka ndryshuar konceptin. Ka bërë projekte për lëvizshmëri të qëndrueshme.

Kemi bërë reforma në transportin publik, ku janë të përfshirë operatorët publikë dhe privatë. Biletat ditore nga 1 janari do të

bëhen edhe për operatorët privat. Do të jetë edhe integrimi i biletave, që do të jenë ditore, javore e mujore, që do të përdoren nga të gjitha operatorët. Tjetra është digjitalizimi i biletave. Nga viti i ardhshëm disa rrugë do të jenë të qasshme vetëm për autobus”, ka thënë Sejdiu.

Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm e Kosovës (KSDW) 2024 aspiron të krijojë strategji dhe zgjidhje gjithëpërfshirëse që adresojnë natyrën e shumanshme të zhvillimit të qëndrueshëm, duke nxitur përparim domethënës në mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore të Kosovës për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme.



Mbrojtja e Selimit kërkon nga prokuroria të mos ndikojë në dëshmitarë gjatë seancave përgatitore

Mbrojtja e Rexhep Selimit ka kërkuar nga trupi gjyqës ta paralajmërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë të mos ndikojë te dëshmitarët gjatë seancave përgatitore në rastin e liderëve të UÇK-së. Lajmin e ka bërë me dije zëdhënësja e Gjykatës Speciale, Angela Griep. “Mbrojtja e Selimit më tej kërkoi nga trupi gjyqës ta paralajmëronte prokurorinë të mos ndikonte në dëshmitarin gjatë seancës përgatitore”, ka thënë Griep

HAGË, 20 SHTATOR - Avokatët mbrojtës të Rexhep Selimit kanë kërkuar nga trupi gjyqës ta paralajmërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) që të mos ndikojë te dëshmitarët gjatë seancave përgatitore. Kështu është bërë me dije nga Angela Griep, zëdhënëse e Dhomave të Specializuara të

Kosovës (DhSK) në Hagë, në konferencën javore për medie. Griep ka thënë se fillimisht trupi gjyqës më 12 shtator kishte hedhur poshtë kërkesën e mbrojtjes së Selimit për reduktimin e disa provave në deklaratat e mëparshme të një dëshmitari, kur ajo t'i paraqitet atij gjatë seancës përgatitore për

të dhënë dëshmi. “Mbrojtja kishte argumentuar se provat përkatëse nuk ishin në listën e provave materiale. Mbrojtja e Selimit më tej kërkoi nga trupi gjyqës ta paralajmëronte prokurorinë të mos ndikonte në dëshmitarin gjatë seancës përgatitore”, ka thënë Griep. Zëdhënësja ka theksuar se trupi gjyqës ka kujtuar se ligji kërkon që gjatë një seance përgatitore, avokati që parashtron pyetje duhet t'i japë dëshmitarit mundësinë për rishikim të deklaratave të mëparshme, edhe kur pjesë të tyre nuk kanë të bëjnë me dëshminë që do të japë. “Kjo bëhet për t'iu siguruar dëshmitarëve mundësi të arsyeshme për t'u njohur me deklaratat e tyre të mëparshme para se ta fillojnë dhënien e dëshmisë. Trupi gjyqës konstatoi se duke pasur

parasysh se kishte përjashtuar një pjesë të madhe të provave të propozuara të dëshmitarit, ishte e arsyeshme që prokuroria t'i shpjegonte dëshmitarit se kishte ende prova të rëndësishme që ai lejohej të jepte. Trupi gjyqës përfundoi se kjo u bë në një mënyrë që nuk ishte e paarsyeshme ose e padrejtë”, ka thënë ajo. Sipas Griep, më 13 shtator trupi gjyqës ka miratuar kërkesën e ZPS-së që një dëshmitar të japë dëshmi përmes videolidhjes. Gjithashtu, ajo ka theksuar se, bazuar në rekomandimet e Zyrës Administrative, trupi gjyqës urdhëroi më tej modifikimin e orarit të seancës në mënyrë që dëshmitari ta fillonte dhënien e dëshmisë në orën 12:00 ditën e parë dhe në orën 11:00, në ditët në vijim. “Për ta përdorur kohën në sallë të

gjyqit me efikasitet, trupi gjyqës urdhëroi prokurorinë të përpigjej të caktonte dëshmitarë rezervë për dhënien e dëshmisë midis orës 9:00 dhe 10:30 paradite”, ka thënë ajo. Griep ka thënë se në të njëjtën ditë trupi gjyqës ka miratuar kërkesën e ZPS-së, ku është konstatuar se pranimi i deklaratave si prova dhe provave materiale shoqëruese të 12 dëshmitarëve ishte i përshtatshëm pasi ata të jenë paraqitur në gjykatë. Veç të tjerash, për këtë çështje gjyqësore Griep ka njoftuar se u është vazhduar paraburgimi Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, si dhe gjatë kësaj jave janë dëgjuar katër dëshmitarë të thirrur nga prokuroria. Seanca e radhës në këtë rast pritet të mbahet të hënën më 23 shtator 2024 në orarin e zakonshëm.

Pjetër Shala: Kemi gjetur fjali të ndryshuara gjatë përkthimeve, nuk e di se në çfarë mënyre jam dënuar

HAGË, 20 SHTATOR - Gjatë konferencës së Apelit, Pjetër Shala është ankuar se gjatë seancave kur është thënë fjala përfundimtare, në transkriptimet e tyre kanë gjetur më shumë se 213 fjalë të ndryshuara. Ai është ankuar se nuk e ka në gjuhën shqipe për të parë se si ka rrjedhur gjykimi i tij që nga fillimi deri në tri ditët e fundit. “Unë kam një shqetësim shumë të madh sa i përket për tri ditë seancë të mëparshme 15, 16, 17 kur ishte leximi përfundimtar. Vetëm për tri ditë gjetëm mbi 213 fjalë të ndryshuara, jo gabimisht të përkthyer, por të ndryshuara. Dhe unë nuk e kam akoma në gjuhën shqipe rrjedhën si ka rrjedhë gjykimi im prej fillimi deri në ato tri ditët e fundit. Nuk e kam pas vëmendjen se nuk ma ka marrë mendja se bëhen gabime të tilla, që të ndryshohet fjala. Mirëpo, më 15,16 dhe 17 e keni të vërtetuar se ka 230 gabime, ndryshime fjalë se nuk janë gabime por ndryshime të fjalive që ia humb të gjithë kuptimin e gjithçkafit”, ka pohuar Shala, raporton “Betimi për

Drejtësi”.

Ai u ankua se nuk e ka në dispozicion në gjuhën shqipe edhe aktvendimin ndaj tij duke shtuar se nuk e di se në çfarë mënyre është dënuar. “Tani unë akoma nuk e kam as aktvendimin e përkthyer. Unë nuk e di si do të ankoheja. Bëjmë ankesën kur unë nuk e di se në çfarë mënyrë dënohem. Më jepet aktvendimi, dënohem për vrasje që nuk kam vrarë kurrë në jetën time. Ma shpjegojnë avokatët e unë nuk mund të besoj përderisa nuk e kam zyrtarisht në mënyrë zyrtare, para vetes ta lexoj dhe kuptoj se për çka jam i dënuar dhe nuk e di si kam mundësi që të punoj me avokatët dhe të bëjmë ankesa kur akoma nuk e kam të përkthyer”, ka thënë Shala.

Shala ishte duke folur kur seanca kaloi në përmbajtje të redaktuar. Përpara kësaj, kryetarja e panelit të Apelit, Michele Picard, ka thënë se përkthimet e përfunduar dhe redaktimi i përkthimit pritet të dorëzohen në javën e fundit të tetorit sa i takon të gjithë procesit gjyqësor të Thaçit.



Çfarë po ndodh me letrën e Bërnabiqit?

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Disa deklarata diametralisht të kundërta janë bërë së voni në Bruksel dhe në Prishtinë sa i përket një çështjeje: tërheqjes ose jo të një letre që i ishte dërguar Bashkimit Evropian nga ish-kryeministrja serbe.

Emisari i BE-së ka thënë se Serbia e ka tërhequr letrën, nëpërmjet së cilës kishte shprehur rezerva ndaj marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën, e njohur si Marrëveshja e Ohrit. Por, kryenegociatori i Kosovës tha se ndërmjetësi evropian ka dashur të thotë se blloku po punon për tërheqjen e shkresës.

Çështja e tërheqjes ose jo të një letre që Serbia ia ka dërguar Bashkimit Evropian lidhur me Kosovën është mbështjellë me mister, pas deklaratave kundërtënësë të bëra së voni nga blloku evropian dhe nga autoritetet e Kosovës, përderisa udhëheqja serbe nuk ka bërë asnjë koment konkret.

Më 6 shtator, pas një takimi në Prishtinë me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, emisari evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, deklaroi se Serbia e ka tërhequr letrën e kryeministres së atëhershme, Ana Bërnabiq.

Nëpërmjet kësaj letre, dërguar në Bruksel në dhjetorin e vitit 2023, Serbia shprehu rezerva për Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën dhe për Aneksin e zbatimit të saj, që BE-ja i sheh si marrëveshje historike në



procesin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Por, pas takimeve me Lajçakun, Bislimi ka thënë më 17 shtator se ka kuptuar që letra, në të vërtetë, s'është tërhequr. “Ajo që ka dashur ai të thotë në Prishtinë është se po punohet me Serbinë që letra të tërhiqet. Letra nuk është tërhequr dhe as nuk ka kërkesë për tërheqjen e saj nga ana e Serbisë ende”, ka thënë Bislimi.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se Brukseli nuk i komenton deklaratat e asnjërës palë, duke shtuar se është Serbia ajo që duhet të pyetet lidhur me veprimet e saj. “Ne presim që palët më në fund të përqendrohen te zbatimi (i marrëveshjes) dhe të mos humbin kohë në taktika devijuese”, ka thënë Stano.

Burime të “Radios Evropa e Lirë” në BE kanë thënë se askush në Bruksel nuk ka deklaruar se letra është tërhequr, përveç Lajçakut. Stano më herët kishte deklaruar se nuk kishte çfarë t'i shtonte asaj që kishte thënë Lajçak në kryeqytetin kosovar.

Ndërkaq, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, as nuk ka mohuar, e as pohuar se shteti i tij e ka tërhequr këtë letër.

Toby Vogel nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Bruksel ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se letra e Bërnabiqit gjithmonë ka qenë “pak e mistershme”. Ai ka vlerësuar se edhe dërgimi i saj ishte i pazakontë, pasi Bërnabiq ia ka dorëzuar atë një zyrtari të nivelit të mesëm të Shërbimit për Veprim të Jashtëm të BE-së, gjë që, sipas tij, është edhe shkelje e protokollit. “Duke pasur parasysh

faktin se BE-ja atëbotë nuk njoftoi për këtë letër, është jashtëzakonisht e pazakonshme që tani të njoftojë për tërheqjen e saj”, ka thënë Vogel. Sipas tij, njoftimi për një tërheqje të tillë do të duhej të bëhej nga Qeveria e Serbisë. “Duke njoftuar për këtë tërheqje të pretenduar, edhe nëse del të jetë e vërtetë, Lajçaku u shndërrua në zëdhënësi të Qeverisë së Serbisë. Nëse asgjë tjetër, kjo e vë në pikëpyetje gjykimin politik të Lajçakut”, ka thënë Vogel.

Nikolla Burazer nga Qendra për Politikë Bashkëkohore në Beograd, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se BE-ja ua ka bërë të qartë palëve se duhet ta zbatojnë pa kushte Marrëveshjen, nga e cila varet edhe rruga evropiane e dy vendeve.

Për Serbinë, marrëveshja është pjesë e kapitullit 35 të kornizës negociuese për anëtarësim në BE.

Burazer ka vlerësuar se BE-ja “nuk e merr seriozisht” letrën e Bërnabiqit dhe rezervat e shprehura përmes saj nga Beogradi. “Pavarësisht nëse (letra) është tërhequr apo jo, ajo në asnjë mënyrë nuk ndikon në obligimin e palëve. BE-ja e sheh (marrëveshjen) si zotim që palët duhet ta përmbushin, nëse duan të ecin përpara në integrimin evropian”, ka thënë ai.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, një vit më parë kishte vendosur tri kushte për angazhim në nivelin politik të dialogut. Një nga to ishte edhe

tërheqja e letrës.

Në letër, Bërnabiq ka thënë se marrëveshja është e pranueshme për Serbinë vetëm në një kontekst që nuk i referohet njohjes de facto dhe de jure të Kosovës. Aty, po ashtu, thuhet se Beogradi nuk pajtohet me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara apo në mekanizma dhe në agjenci që ekzistojnë në kuadër të OKB-së.

Për Vogel, njoftimi i Lajçakut për një tërheqje të letrës së Bërnabiqit tregon se Perëndimi me çdo kusht po tenton të tregojë se dialogu po vazhdon. “Ata në mënyrë të dëshpëruar duan ndonjë lajm të mirë, sikurse na e dëshmoi edhe tërheqja e pretenduar e letrës së Bërnabiqit, si dëshmi se dialogu po jep rezultate, se marrëveshjet e Brukselit/Ohrit janë të vlefshme, dhe se qasja e Perëndimit më në favor të Serbisë dhe ndëshkuese për Kosovën është duke funksionuar”, ka thënë ai.

Si Vogel, ashtu edhe Burazer, janë pajtuar se Kosova dhe Serbia aktualisht nuk janë të interesuara për normalizim, por se duan që “të blejnë kohë”, para se t'i zbatojnë zotimet e procesit që nisi më 2011.

Ndërkaq, Lajçaku kishte deklaruar për “REL”-in se shoqëritë në Kosovë dhe Serbi nuk janë gati për normalizim. Sa i përket të ardhmes së dialogut, Burazer nuk pret ndryshime në format dhe në qasje, kurse Vogel kërkon model të ri, në mënyrë që procesi të ketë sukses.



Organizohet aktiviteti "Ta pastrojmë Kosovën"

PRIZREN, 20 SHTATOR - Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren ka organizuar të premten aktivitetin "Ta pastrojmë Kosovën" pas thirrjes së OJQ "Let's Do It", që synon ndërmarrjen e disa veprimeve për pastrimin e lokacioneve ku janë

krijuar pika ilegale të mbeturinave. Komuna e Prizrenit ka përzgjedhur si lokacion "Liqenin e Vërmicës", një zonë ku pas një sezoni shumë të thatë janë grumbulluar shumë mbetje plastike për shkak të prurjeve nga të gjitha

vendbanimet nëpër të cilat kalon Drini i Bardhë. Me këtë rast u vendosën edhe katër tabela me mbishkrimin "Ruaje mjedisin" me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rëndësinë e ruajtjes së ambientit.

Të dielën, në dyvjetorin e vdekjes së veprimtarit Ali Ahmeti, bëhen homazhe në Shipol

MITROVICË, 20 SHTATOR - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se me rastin e dyvjetorit të vdekjes së veprimtarit Ali Ahmeti, më 22 shtator (e diel), ora 11:00, do të bëhen homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK-së në Shipol. "Të nderuar bashkëqytetarë, familjarë të Dëshmorëve të Kombit, Invalidë dhe Veteranë të UÇK-së. Në dyvjetorin e vdekjes së

bashkëluftëtarit dhe veprimtarit studentor të vitit '97, Ali Ahmeti, ju ftojmë që të na nderoni me praninë tuaj më datë 22.09.2024 (e diel), ora 11:00, në homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK-së në Shipol. Ardhja juaj do të nderojë gjakun, veprën dhe sakrificën e dëshmorëve për liri. Lavdi jetës dhe veprës së dëshmorëve!", ka njoftuar komuna e Mitrovicës.



Në bibliotekën e qytetit në Podujevë vendoset këndi i leximit nga Ambasada e Gjermanisë



PODUJEVË, 20 SHTATOR - Në bibliotekën e qytetit në Podujevë është vendosur një kënd i leximit me libra gjermanë, të cilën e ka dhuruar Ambasada e Gjermanisë në Kosovë. Përmes këtij këndi me libra dhe revista gjermane, lexuesit kanë

mundësinë ta njohin edhe historinë e krijimit të Kushtetutës gjermane, rolin e të rinjve në demokracinë e sotme etj. Në hapjen e këndit të leximit mori pjesë drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Humolli dhe shefja e kabinetit të

kryetarit, Edona Çitaku. Drejtoresha Humolli e falënderoi përfaqësuesin nga Ambasada e Gjermanisë, Christian Bottcher, për donacionin e dhuruar, duke e vlerësuar hap të rëndësishëm për njohjen e historisë dhe kulturës gjermane nga të rinjtë tanë.

Nisin punimet për asfaltimin dhe ndërtimin e kanalizimit në shtatë rrugë të Zhegrës

GJILAN, 20 SHTATOR - Në vazhden e investimeve që po bëhen në fshatrat e komunës së Gjilanit, tashmë punime në kanalizim e asfaltim të rrugëve kanë filluar edhe në fshatin Zhegër. E për të parë punimet të cilat po realizohen aty ka dalë edhe kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin për Shërbime Publike, Infrastrukturë e Banim,

Kushtrim Ibrahim. Kryetari i komunës së Gjilanit tha se rreth 180 mijë euro është vlera e projektit të ardhshëm në fshatin Zhegër. Hyseni tregoi se gjithsej do të asfaltohen dhe ndërtohet kanalizimi në shtatë rrugë. "Infrastruktura në fshatrat tona po përmirësohet çdo ditë, duke e bërë jetën më të lehtë", tha kryetari Hyseni.




Djali i heroit Sali Çekaj do të jetë kandidat për deputet në listën e LDK-së

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Djali i heroit Sali Çekaj, Hyseni, i është bashkuar Lidhjes Demokratike të Kosovës. Lajmin për aderimin e tij e ka bërë publik kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, në "Facebook". "I biri i heroit Sali Çekaj, Hyseni, na u bashkua në rrugëtimin tonë të djathtë. Atë,

Valentinën e djalin e tyre Saliun - që mbante me krenari emrin e heroit - i pritëm në LDK së bashku me bashkëluftëtarë të babës së tij, tani bashkëveprimtarë të tij politik. Hysen Çekajn do ta propozoj si kandidat tonin për deputet nga mërgata, përkatësisht nga dega jonë

në Gjermani. Si kandidat i mërgatës, ai vazhdon rrugëtimin politik e ideologjik të prindit të tij, heroit Sali Çekaj, në shtëpinë e vetme rugoviste e të demokracisë. E djathta po bashkohet po bëhet një. Në një vend, në një shtëpi, në një rrugëtim!", ka shkruar Abdixhiku.



Shtatë pikat e Vuçiqit dhe marrëveshja e Brukselit



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Status quo, si zgjidhje: Aleksandar Vuçiq, një politikan dinak dhe i rrezikshëm, pas masave që ndërmori Qeveria e Kosovës në veri të vendit, asnjëra e kundërligjshme apo diskriminuose, paralajmëroi masa të rrepta kundër Kosovës duke lënë të gjithë në pritje 72-orëshe. U krijua një hapësirë spekulative e që edhe ishte qëllimi i Vuçiqit dhe Serbisë për masat e mundshme. Si masë kryesore përflitej se Serbia do ta shpallë Kosovën si pjesë të okupuar dhe rreth kësaj pamundësie zhvilloheshin thujta të gjitha debatet dhe analizat, në Kosovë dhe Serbi, kryesisht në ndërkohë që për adresat e fuqishme vendimmarrëse nuk paraqet kurrfarë problemi. Vuçiqi dhe Serbia këtë spekulim e hodhën në treg si një fluskë sapuni apo letër lakmuri për të matur pulsën e reagimit në Kosovë, Serbi dhe atij ndërkombëtar. Dhe, kur erdhi koha e shpërthimit të bombës, Vuçiqi doli me shtatë kërkesa me të cilat injorantët e politikës filluan të tallen, sikur të dilnin nga përralla: “Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët”. Mendoj dhe jam i sigurt se këto shtatë pika të Vuçiqit janë shtatë bomba që paraqesin rrezik për Kosovën nëse vazhdojnë të përqeshen nga politikanë injorantë dhe analfabetë të Kosovës, që reaguesin në kor, duke u tallur me këto propozime. Argumentet që i përdorin janë se vet Vuçiqi ka krijuar terren për gjendjen ekzistuese në veri dhe tash, i dorëzuar para Kurtit koqemadh, kërkon mëshirë duke u kthyer në pikën zero. Është e vërtetë se Vuçiqi ka kontribuar që gjendja të jetë ajo që është sot sepse në atë kohë ka pasur nevojë politike për këtë gjendje ndërsa, sot ka nevojë për rikthim të gjendjes prandaj doli me këto shtatë pika pavarësisht a realizohen a jo. Lojën ende po e luan në Kosovë duke tregtuar me territor dhe procese ekskluzivisht të brendshme të Kosovës. Dhe, nëse analizohen këto kërkesa del se nëse jo të gjitha këto, disa prej tyre janë shpata të ndërkombëtarëve mbi kokën e Albin Kurtit që ia përmendin në çdo takim dhe të cilat i kanë përdorur si fakte për t'i futur sanksione Kosovës dhe për ta izoluar Kurtin në takime të rëndësishme ndërkombëtare.

Menjëherë pas bërjes publike të këtyre kërkesave ndërkombëtarët e lavdëruan Vuçiqin, si partner konstruktiv që po angazhohet për integrimin e serbëve në institucionet e Kosovës ndërsa që Kurtin nuk e përmend askush, as nuk e thërrasin në takime, as nuk i heqin sanksionet. Vuçiqi, mjeshhtërisht topin e vendosi në fushën e përgjegjësisë të Kurtit dhe Kurtit i kërkohet t'i pëmbushë disa kërkesa të Vuçiqit, të maskuara si integrim i serbëve. Militantët e LVV-së, që nuk shohin më larg se hunda, po festojnë fitoren e Kurtit 8 me 2 sepse, aq shohin e aq dinë. Ata nuk janë aty për të menduar por për të dëgjuar dhe për të mos e kundërshtuar Liderin Suprem. Si shpërblim e kanë një vend pune, të drejtën e punësimit të çdo familjari, të drejtën e vjedhjes të çdo gjëje, të drejtën që ministret t'i caktojnë burrat e tyre si ndarës të tenderëve, kur të duan dhe kur të duan, të vjedhin mëditje, rezerva ushqimore të shtetit, subvencione qindra-mijëra euro për familjarë dhe bashkëpartiakë si puna e HAJN-rullahut, shkarkim nga puna dhe pozita e kundërshtarëve politikë që i trajtojnë si armiq, nxitje të urrejtjes ndaj luftës dhe UÇK-së, dërgimi i dosjeve dhe dëshmitarëve të mbrojtur kundër udhëheqësve të luftës dhe të shtetit që po mbahen si rob lufte dhe paqeje në Hagë, kapja e çdo pozite, institucioni a shërbimi e shumë të tjera që kurrë dhe asnjëherë nuk bëhen pa lejen e Albin Kurtit. Ky është çmimi që e paguan Albin, pa humbur asnjë cent nga xhepi i tij, për ta mbajtur pushtetin sikur që është edhe shpërblimi për injorantët funksionalë të LVV-së, që as në ëndrën më optimiste nuk kanë besuar se: “Erdhi dita për të ulur prapanicat aty ku i kanë dhe se mund të bëjnë ç'të duan, pa i dhënë përgjegjësi askujt...”. U erdhi dita udhëbërësve, jugonostalgjikëve, serbofilëve dhe antikombëtarëve të bëjnë shtatë palë qejfe në grazhdin e Albin Kurtit. Erdhi koha që ata që kontribuuan për lirinë e vendit të përndiqen nga Albin Kurti dhe truarët antikombëtarë. Vuçiqi, kërkesat nuk i ka bërë pa një sherr por për të penguar proceset stabilizuese dhe për t'i rënduar pozitën ndërkombëtare të Kosovës, edhe ashtu shumë të rëndë në saje të injorantëve dhe antikombëtarëve që kinse po qeverisin, secili më injorant se tjetri. Tash, presioni nuk bie mbi Vuçiqin por mbi Kurtin, Serbia nuk ka sanksione, Kosovës mund t'i shtohen. Këtu është përparësia e Vuçiqit dhe këtu është fusha e minuar për Kurtin ku e sollën antishqiptari Veton Surroi dhe mercenari Weller, të parin e shpërbleu me një pagë mbi 3000 euro në muaj, me punësimin e

vajzës në Haremin e Injorantëve të qeverisë kurse mercenarinë Weller, me para që askush nuk e di sa sikur që edhe gruan ia emëroi si diplomate a ambasadore në shtetin ku Kurti i rreshkë herdhët gjatë muajve të verës e që, në të njëjtën kohë është vendlindja politike, biologjike dhe kombëtare e Dejana Mihalit, lavatriques për truvogëlit e LV-së.

Marrëveshja e Brukselit midis Vuçiqit dhe Kurtit: Një bartës i postit të lartë institucional dhe partiak, kohë më parë deklaroi se bisedimet me Serbinë kanë vdekur dhe se Banjska është gozhdë e fundit në arkmortin e këtyre bisedimeve. Kjo ishte deklarata e “as kësaj e as e asaj” cilësim për Asociacion Zajebrnicën të një personaliteti, pa personalitet, të një personi rast sui generis anatomik, që ndonëse ka kurriz anatomik, është pakurizorë ekzemplarë, i panjohur si rast shkencor deri më sot, moralizues pa fatura morale politike, dyfytërësh në teatrin e kukullave shumëfytërëshe, krejt me qëllim ta mbulojë dhe arsyetojë Liderin Suprem dhe për një grusht vota të pëshurta për të qëndruar në pushtet. Nuk kaloi as një javë dhe: “në arkivolin e gozhdur për vdekje të bisedimeve...”, në Bruksel shkoi një kufomë e gjallë njerëzore, politike dhe morale, rrenc dhe mashtrues ordiner, me shumë fytyra dhe jo besnik, paradoksalisht me emrin Besnik për të biseduar pikërisht me Serbinë për çështje ekskluzivisht të brendshme siç është çështja e Urës së Ibrit. Edhe pas bisedimeve, në përpjekje që kurvërinë politike ta mbulojë me një cipë patriotike, fshehu se ka biseduar për Urën e Ibrit dhe se e ka refuzuar vazhdimin e bisedimit trepalësh shkaku se: “Serbia paska dalë me propozime

të papranueshme për Kosovën sikur që qenka Asociacion Zajebrnica...”. Po në atë kohë, shefi i tij, KM Kurti, në një intervistë dhënë Al Xhaziras pranoi se e ka pranuar themelimin e Asociacion Zajebrnicës, jo si të ndarë por në pako, bashkë me Arbitrazhin, shtetin e Kishës Serbe brenda Kosovës, autonominë territoriale dhe politike të serbëve në Kosovë, faktit se Marrëveshja e Brukselit dhe shtojca e Ohrit nuk e paragjykon statusin e Kosovës dhe me asgjë nuk kërkon nga Serbia njohjen e pavarësisë së Kosovës. Pikërisht, këto janë gozhdat që i janë ngulur shtetit të Kosovës nga Albin Kurti në Marrëveshjen e Brukselit e që Kosovën e shndërrojnë në shtet kufomë, që do të mbijetojë nëse Serbia ka vullnet dhe interes për këtë. Këto gozhdat janë farkëtuar nga antishqiptari dhe profiteri i luftës, Veton Surroi dhe mercenari i angazhuar thujta nga të gjitha Qeveritë e Kosovës, Mark Weller. Këtë sabotim të shtetit të Kosovës e arsyetojnë: “si kompromis i dhimbshëm” e që, në fakt atyre nuk iu shkakton asnjë dhimbje përveç përfitimeve materiale. Kurti, tani duhet ta paguaj çmimin e nënshtrimit ndaj besimit që ka pasur për antishqiptarin Surroi dhe mercenarin Weller që e kanë shndërruar në një sadomazokist të pavetëdijshëm. Tash, kur i doli pija, Kurti po kundërshton maksimalisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje duke blerë kohë dhe pushtet. Aktualisht, lufta në Ukrainë i përshtatet edhe Kurtit si dhe Vuçiqit shkaku se janë jashtë një presioni të fuqishëm ndërkombëtar për zbatim të marrëveshjes. Gjithashtu, Kurti dhe Vuçiq shpresat i kanë varur te zgjedhjet në Amerikë me 5 nëntor 2024. Vuçiqi voton për fitoren e Trampit me shpresë që, përmes Ukrainës fiton edhe Serbia. Në anën tjetër, Albin Kurti voton për

Harris, vetëm të mos fitojë Tramp, që ia ka frikën se mund ta rrëzojë nga pushteti. Edhe opozita kosovare lutet që të fitojë Tramp në mënyrë që t'ua heqë qafe Albinin. Tramp, sigurisht e përkrah Vuçiqin por nuk besoj se do të merret me Albinin. Nuk paraqet asnjë interes për të. Albinin nuk e ka askënd prapa përveç Dimal Bashës, Halil Thaçit, Mefit, Donika Shvarcit dhe Fatonit, narkomanëve të Prizrenit, Agim Bahtir trimin, Xhelal dhe Hysen dezertorët, Faraonin egjiptas dhe deputetët e Hajkobillës. Këta dhe të tjerët që për shkak të higjienës mentale nuk po i përmend, paraqesin forcë në grazhdin dhe kotecin e vet, por në planin ndërkombëtar, ende nuk janë legalizuar si forcë politike dhe destabilizuese. Albin Kurti nuk e ka pas veti as Shqipërinë, Maqedoninë e as Mongolinë. Në anën tjetër, Serbia ka prapa vetes Kinën, Rusinë, Indinë, Iranin, Brazilin, BE-në dhe Amerikën. Prandaj edhe po luan në tokën tonë. Sidomos pas Banjskës, në vend se të forcohet Albin Kurti dhe Kosova, u forcua Serbia dhe Aleksandër Vuçiq. E pabesueshme për një vend normal dhe njerëz normal! Prandaj i marr shumë seriozisht shtatë kërkesat e Vuçiqit, i konsideroj shumë të rrezikshme dhe aspak miqësore. Do të doja që edhe qeveria dhe opozita t'i marrin shumë seriozisht, të bëhen gati që pasojat të jenë të menaxhueshme dhe të bëjnë sa më pak dëm. Pa dëm nuk shpëtojmë. Duket se arma e vetme që na ka mbetur është ajo: “rreth Flamurit të përbashkuar, me një dëshirë, me një qëllim...”. Nuk kemi rrugë apo mundësi tjetër, as për jetesë e as për mbijetesë. Në Evropë dhe botë po rikthehen fuqishëm forcat kombëtare, nacionalizmi pozitiv. Kush jemi me të bëjmë përjashtim!?



Guvernatori i BQK-së takon përfaqësuesin e Thesarit të ShBA-së, flasin për forcimin e bashkëpunimit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga ekipi i tij, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesin e Thesarit të ShBA-së për Evropën Qendrore dhe Lindore, Mathew Haarsager. Diskutimet u përqendruan mbi gjendjen makroekonomike të Kosovës, zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe iniciativat e ndërmarra nga BQK-ja në përputhje me Planin e saj Strategjik 2024-2028.

Guvernatori Ismaili nënvizoi stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar, duke vënë në pah performancën e qëndrueshme të sektorit, përfshirë normën e ulët të kredive joperformuese dhe nivelin e lartë të kapitalizimit.



Gjatë takimit guvernatori i BQK-së i shprehu mirënjohjen Haarsagerit për mbështetjen thelbësore të ofruar nga Departamenti i Thesarit amerikan. Ai theksoi përfitimet nga projektet e ndryshme të

përkrahura nga Thesari i ShBA-së, të cilat kishin synim zhvillimin e tregut të obligacioneve qeveritare, krijimin e infrastrukturës së nevojshme të tregut dhe lehtësimin e iniciativave të tjera që

avancojnë sistemin financiar të Kosovës.

Gjithashtu, u diskutuan bashkëpunimet aktuale të mbështetura nga USAID-i, të cilat kanë qëllim krijimin e një kornize

dhe infrastrukture të qëndrueshme të tregut të kapitalit. Këto projekte janë jetike për promovimin e stabilitetit financiar dhe rritjen ekonomike të Kosovës, duke siguruar që sektori financiar të vazhdojë të zhvillohet në përgjigje të nevojave të tregut.

Guvernatori Ismaili ritheksoi rëndësinë e partneriteteve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar të Kosovës. Angazhimi me Thesarin e ShBA-së ka për synim forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe promovimit të një mjedisi të qëndrueshëm financiar në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Të dyja palët në mbyllje të takimit rikonfirmuan zotimin për thellimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit.

Abrashi: Kosova ka regres ekonomik, politika po ndikon negativisht në projektet madhore

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Presidenti i "Exclusive Group", Gazmend Abrashi, në një intervistë për emisionin "Përballje" me kryeredaktorin Muhamet Hajrullahu në "Telegrafi", ka shprehur shqetësime të thella për situatën ekonomike në Kosovë.

Në një periudhë të ndryshimeve të mëdha globale dhe lokale, ekonomia e Kosovës po përballlet me sfida dhe mundësi të reja.

Që nga pandemia, liberalizimi i vizave dhe ndikimi i luftës në Ukrainë, ekonomia botërore ka pësuar tronditje të shumta, e as Kosova nuk ka mbetur e paprekur. Megjithatë, bizneset janë duke ecur përpara, duke kapërcyer pengesat dhe duke kërkuar mundësi të reja.

Ndërmarrësi Abrashi ka folur

për sfidat e të bërit biznes në vend, për problemet e pengesat kryesore të ekonomisë sot në Kosovë. Ai i ka kritikuar institucionet për fokusin e tyre të tepruar në politikë, duke lënë pas dore zhvillimin ekonomik dhe projektet madhore.

Abrashi theksoi se "Kosova më shumë po merret me politikë e shumë pak me ekonomi. Njerëzit e politikës duhet të kuptojnë se mund të jenë partnerë interesantë në politikë nëse kemi ekonomi të zhvilluar". Sipas Abrashit, gabimet kardinale në nënshkrimin e marrëveshjeve të CEFTA-s dhe MSA-së kanë kontribuar në këtë regresion. "Në atë kohë CEFTA është një dokument që përfshin shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavinë, që nënkupton tregti të lirë, pra nuk paguan doganë", tha Abrashi.



Ai shpreh shqetësim për humbjet e mëdha ekonomike, duke theksuar se: "Kosova humb rreth 600 milionë euro në vit nga marrëveshja e CEFTA-s, pa

pasur asnjë përfitim konkret". Kjo, sipas Abrashit, tregon një rezultat zero nga lëvizjet e këtyre marrëveshjeve dhe një rritje të çmimeve për shkak të uljes së

doganave. Abrashi ka folur mungesën e investimeve të huaja në Kosovë, ndikimin që ka pasur liberalizimi në tregun e vendit, inflacioni etj.

Mbahet punëtorja dyditore për klasifikimin e vendbanimeve në Kosovë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), me mbështetjen e UNFPA-së, ka nisur një punëtori dyditore me fokus në klasifikimin e vendbanimeve urbane dhe rurale në Republikën e Kosovës. Kjo punëtori, e cila po zhvillohet me pjesëmarrjen e ekspertëve nga ASK dhe institucione të tjera qeveritare, vjen pas përfundimit të regjistrimit të popullsisë së vitit 2024 dhe synon t'i përshtatë praktikat ndërkombëtare me nevojat e Kosovës.

Procesi i klasifikimit të vendbanimeve është



thelbësor për zhvillimin e mëtejshëm të politikave publike dhe strategjive të planifikimit urban dhe rural. Punëtorja synon të diskutojë dhe përshtatë metodologjitë e

njohura ndërkombëtare të Eurostat dhe OECD, të cilat ndihmojnë në përcaktimin e zonave urbane dhe rurale, bazuar në kriteret si dendësia e popullsisë, aktivitetet

ekonomike, përdorimi i tokës, infrastruktura etj.

Gjatë dy ditëve të punëtorisë ekspertët do t'i analizojnë të dhënat e mbledhura nga regjistrimi i popullsisë dhe do të përcaktojnë kriteret që ndihmojnë në dallimin mes zonave urbane dhe rurale. Ky proces është vendimtar për sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime, përmirësimin e infrastrukturës dhe hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

Punëtorja ka rëndësi të veçantë në kontekstin e përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm,

duke ndihmuar në matjen dhe monitorimin e përparimeve në përmirësimin e jetesës në të dyja zonat, urbane dhe rurale. Mbështetja e UNFPA-së në këtë aktivitet thekson rëndësinë që ky proces ka për të ardhmen e politikave statistikore dhe zhvillimore të Kosovës.

Në përfundim të kësaj punëtorie pritet të krijohet një kornizë e qartë për klasifikimin e vendbanimeve, e cila do të ndihmojë në planifikimin strategjik të resurseve dhe zhvillimin e politikave të balancuara në nivel kombëtar dhe lokal.

Fillimet e njerëzimit deri në civilizim



Përgatiti: **Veseli MAKOLLI**
(pjesë nga libri *Historia e botës e historianit britanik Somerset Fry*)

Sot, Toka besohet të jetë rreth gjashtë miliardë vjet e vjetër. Njeriu (nëse numërojmë paraardhësit e tij primitivë) ka ekzistuar vetëm për rreth 750 mijë vjet, ndërsa njeriu i qytetëruar, një njeri që kultivon tokën, prodhon ushqim dhe ka një formë të jetës së organizuar në komunitet, ka ekzistuar në Tokë para vetëm gjashtë mijë deri në tetë mijë vjet. Kjo është rreth një e milionta pjesë e moshës totale të botës.

Në këtë periudhë kohore relativisht të shkurtër, njeriu përparoi nga guetar dhe bari, në shpikës të rrotës, mjeshtrë i aftë poçarie dhe krijesë që ndjeu nevojën për shoqëri të organizuar, deri të një qenie e arsimuar e aftë të ngrihet nga Toka dhe të zbresë në Hënë.

Për mijëra vjet njeriu jetoi pothuajse si një kafshë. Njeriu i hershëm u zhvillua shumë ngadalë. Në atë kohë, Toka ishte e mbuluar me një shtresë të trashë akulli dhe akullnajat e mëdha u përhapen në të gjithë sipërfaqen e saj. Kjo periudhë quhet Epoka e Akullnajave.

Mbetjet e ruajtura të njeriut të parë primitiv janë rreth 750 mijë vjet të vjetra. Ne e quajmë atë Australopitëkus dhe gjurmët e tij u gjetën në Afrikë. Ndoshta në të ardhmen, me metodat shkencore, të tilla si metoda për përcaktimin e moshës së përafërt duke përdorur karbonin radioaktiv, do të gjejmë edhe ndonjë paraardhës të tij më të vjetër. Australopitëkusi nuk ishte njeri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ai kishte një tru shumë të vogël, më pak se gjysma e trurit

tonë. U deshën një çerek milion vjet, që njeriu të zhvillohej deri në fazën tjetër si Pitekanthropus i cili mund të thuhet se ishte ekzemplari i parë i një qenie pothuajse njerëzore. Ai bën kalimin midis majmunit dhe njeriut. Eshtrat e tij janë gjetur në Indonezi, Afrikë, Evropë dhe Kinë. Duket se është shfaqur gjysmë milion vjet më parë. Koka e tij mbështetej drejt mbi shtyllën kurrizore dhe sytë e tij ishin vendosur në mënyrë që të arrijë një imazh tredimensional, i cili e lejoi atë të vlerësonte distancën. Truri i tij ishte pak më i madh. Duket se ai tashmë dinte të bënte vegla primitive nga guri dhe stralli.

Ajo periudhë e hershme, që shtrihet nga rreth 500 mijë vjet deri në rreth 10 mijë para Krishtit, quhet Epoka e Gurit, ose Paleoliti. Ajo është e ndarë në tri periudha: e poshtme, e mesme dhe e sipërme, dhe secila përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin e njerëzimit. Pitekanthropusi është një proto-njeri nga Paleoliti i Ulët.

Lloji tjetër i proto-njeriut u shfaq rreth 80 mijë vjet para Krishtit. Ne e quajmë atë Neandertali, pasi që eshtrat e tij u gjetën për herë të parë në Neandertal, një luginë në Gjermani. Truri i tij ishte pothuajse tri herë më i madh se truri i Pitekanthropusit dhe pak më i vogël se truri i njeriut modern. Edhe pse ishte shumë inteligjent, ai deri në vitin 25 mijë vjet para Krishtit, pothuajse plotësisht është zhdukur. Kohët e fundit, mbetjet e një varri të Neandertalit që datojnë 60 mijë vjet para Krishtit, u gërmuan në Bagdad. Kjo dëshmon se njeriu Neandertal tashmë dinte për ritualet karakteristike të qytetërimit...

Neandertali po shuhej ngadalë. Paralel me të në atë kohë, është edhe një tjetër paraardhës i njeriut modern ne botë të cilin ne e quajmë Homo Sapiens (që do të thotë "njeri i arsyeshëm" në latinisht). Me sa dimë, ai nuk kishte asnjë lidhje me Neandertalin dhe nuk dihet prejardhja e tij.

Ai u shfaq ndoshta në fund të Neolitit të Sipërm.

Homo Sapiensi u shfaq në pjesë të ndryshme të botës në të njëjtën kohë. Kafka e tij ishte shumë më e zhvilluar se ajo e paraardhësve të tij dhe për këtë arsye ai u zhvillua shumë më shpejt.

Ai jetonte gjithashtu në shpella, veçanërisht në ato që hapjet e të cilave kishin pamje nga jugu, për t'u strehuar nga të ftohtit dhe erërat nga veriu dhe lindja. Ai u përpoq të qetësohej sa më shumë në ato shpella e tenda dhe mësoi të bënte vegla e armë dhe të bënte zjarr...

Nga fundi i epokës së sipërme të gurit, rreth vitit 15 mijë vjet para Krishtit, njeriu kishte tashmë një shigjetë, një shpatë, një sëpatë, pastaj vegla me dorezë për bujqësi dhe zeje, fuzhnjë për peshkim, madje edhe gjilpëra për qepjen e rrobave prej leshi dhe liri...

Vetë ky përparim tregon epërsinë tashmë domethënëse të njeriut të ri ndaj paraardhësve të tij. Ai tani për herë të parë fillon të interesohet për gjërat rreth tij që nuk kanë të bëjnë vetëm me ushqimin ose kërkimin e strehimit. Me fjalë të tjera, njeriu i ri ndjeu nevojën për t'u shprehur. Kështu hasim në fillimet e artit, paraqitje shumë të përafërta të asaj pjese të mjedisit të tij që ai e konsideronte të rëndësishme. Figura të gdhendura kafshësh u gjetën në Sahara, ku në atë kohë

ekzistonin kushtet për jetë. Shpellat në Spanjë dhe Francë na zbuluan gjëra të jashtëzakonshme – pikturat, vepra arti të njeriut të ri. Në Altamira, në Spanjë, u gjet një vizatim i një bizoni në madhësi reale, ndoshta i bërë 35 mijë vjet më parë, dhe në shpellat e Leskosë, në Francë, rreth 12 mijë vjet para Krishtit...

Nga fundi i Paleolitit të Sipërm, njeriu i ri tashmë ishte përhapur gjerësisht në Tokë. Ai kishte organizuar tashmë komunitete të vogla në shumicën e zonave ku u vendos qoftë në Lindjen e Mesme, Gadishullin Ballkanik apo Afrikën Qendrore. Ai tashmë kishte filluar të zgjedhë shokë të përhershëm dhe të jetojë në një lloj njësie familjare, e cila më vonë do të bëhet një nga tiparet kryesore të qytetërimit.

Periudha tjetër e zhvillimit njerëzor është Epoka e Mesme e Gurit, ose Mezoliti. Krahasuar me paleolitin, ajo ishte shumë e shkurtër dhe karakterizohej kryesisht nga përparimi i shpejtë në saktësi dhe përdorimi i veglave prej guri. Ky përparim, natyrisht, nuk ishte i njëjtë në të gjitha vendet.

Në brezin pjellor gjysmërrethor që shtrihet nga rrëzë kodrave në veriperëndim të Irakut deri në Gjirin Persik, periudha e Mezolitit filloi rreth 10 mijë vjet para Krishtit dhe zgjati rreth tre mijë vjet. Në Evropën veriore dhe perëndimore, përkundrazi, kjo epokë zgjati shumë më gjatë, kryesisht sepse ndikimi i qytetërimit nga ajo zonë arriti shumë ngadalë në Evropën veriperëndimore.

Rreth vitit 7000 para Krishtit, njeriu i ri ishte vendosur tashmë në atë zonë pjellore dhe jetonte atje në komunitete të veçanta klanore për disa breza. Ai kishte


kohë të mjaftueshme për të njohur mjedisin e tij, për të mësuar se si ta përdorte atë dhe për të vlerësuar gjendjen shpirtërore të natyrës. Ai kishte vënë re tashmë se uji ndihmon perimet dhe drithërat të rriten. Ai pa që dielli e kthen baltën në një material të fortë dhe rezistent, prandaj filloi të ndërtonte kasolle prej balte.

Ai tashmë po qëndronte, në fakt, në pragun e një hapi të madh përpara në zhvillimin e tij, pikërisht në kufirin midis parahistorisë dhe qytetërimit. Ai ishte gati të prodhonte ushqimin e tij dhe të rriste bagëti, që do të jetë një nga hapat më të rëndësishëm në zhvillimin e njerëzimit.

Në këtë epokë të re, e quajtur epoka e Neolitit (ose epoka më e re e gurit, sepse veglat prej guri tashmë ishin shumë të përsosura), njeriu filloi të merrej me bujqësi, duke rritur bimë për ushqim dhe duke zbutur kafshët që shërbenin për të tërhequr ngarkesa dhe ushqim. Ata filluan të rritnin oriz në Kinë dhe Indi, fasule dhe patate në të dy Amerikat, dhe gurë dhe elb në brezin pjellor...

Njeriu i ri e përshtati mënyrën e tij të jetesës me bujqësinë; ai zbuti dhitë, delet dhe bagëtinë që të mos i duhet më t'i gjuajë. Shumë shpejt ai filloi të tregtonte një kulture me një tjetër, një kafshë me një tjetër. Kjo ide e tregtisë dhe shkëmbimit u përhap shpejt dhe e solli njeriun në kontakt me bashkësi të tjera njerëzore.

Në këtë fazë, njeriu mund të thuhet se ishte civilizuar (qytetëruar). Njerëzit më të hershëm të qytetëruar kanë qenë mbase sumerët të cilët kanë jetuar në Mesopotami./Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova e Shqipëria organizojnë Evropianin U16

Prishtinë, 20 shtator - Kosova dhe Shqipëria do të organizojnë bashkë CEV Kampionatin Evropian U16 (femrat), një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e volejbollit të Kosovës. Aplikimi i përbashkët i

të dy vendeve pritet të konfirmohet së shpejti nga Konfederata Evropiane e Volejbollit (CEV), për garën e cila do të zhvillohet në korrik 2025. "Ky kampionat do të jetë aktiviteti më i rëndësishëm që

do të organizohet nga shtëpia kosovare e volejbollit, dhe besimi i dhënë nga CEV është një vlerësim i madh për zhvillimin e volejbollit në Kosovë dhe Shqipëri", thuhet në njoftimin e Federatës së

Volejbollit të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, turneu do të zgjasë 12 ditë, me 16 kombëtare pjesëmarrëse të ndara në dy grupe me nga 8 skuadra, të cilat do të garojnë në fazën finale të këtij Evropiani. Detajet e plota



do të publikohen nga CEV në javët në vijim.

Prishtina deklason Dukagjinin, sot zhvillohen dy ndeshje të tjera në Superligë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 20 SHTATOR - FC Prishtina ka shkëlqyer të premten në përballje me Dukagjinin e Klinës, pasi e ka mposhtur me rezultat 3-0. Ndeshja i ka takuar javës së gjashtë në Superligë dhe është zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali. Kryeqytetasit e nisën më mirë ndeshjen dhe arritën të shënojnë të parët në minutën e 25-të falë autogolit të mbrojtësit Ilir Sylja. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 1-0, derisa tre minuta pas fillimit të pjesës së dytë, Prishtina shënoi edhe golin e dytë me anë të Krasniqit. Prishtina golin e tretë dhe të fundit në ndeshje e realizoi në minutën e 69, kur realizoi Llugiqi. Pas tri pikëve të reja,



Prishtina grumbullon dhjetë pikë, derisa skuadra e Ismet Munishit mbetet në kuotën e pesë pikëve. Sot (e shtunë) do të zhvillohen

dy ndeshje në elitë: Ferizaj - Llapi dhe Suhareka - Feronikeli 74. Llapi pas fitores në ndeshjen e fundit ndaj Dritës synon edhe tri pikë të reja në përballje me

Ferizajn, skuadër e cila nga pesë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar tri humbje, një barazim dhe një fitore. Tri pikë të reja po synon edhe Suhareka ndaj Feronikelit 74. Suharekasit po kalojnë nëpër një formë të mirë dhe do të përpiqen të vazhdojnë të jenë mes skuadrave më të mira. Në anën tjetër, "Nikli" nuk e ka nisur edicionin mirë dhe synon ta fillojë këndelljen me rezultate pozitive nga kjo ndeshje. Ndërsa të dielën zhvillohen dy ndeshje. Spikat derbi i kësaj xhironje dhe i dy skuadrave pretendente për titull, Dritës dhe Ballkanit. Gjilanasit janë vendas dhe do të përpiqen ta regjistrojnë fitoren e tretë në elitën e futbollit të Kosovës, kurse kanë një humbje nga Llapi. Në anën tjetër,

suharekasit, nga pesë ndeshjet e zhvilluara, kanë tri fitore, një barazim dhe një humbje, dhe në këtë ndeshje do të përpiqen ta ruajnë formën e mirë dhe të jenë ndër favoritët kryesorë për titull. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Malishevës dhe Gjilanit. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhironje zhvillohen nga ora 15:00.

SUPERLIGA - Java 6

Prishtina - Dukagjini 3-0

Të shtunën takohen:
Ferizaj - Llapi
Suhareka - Feronikeli 74

Të dielën takohen:
Drita - Ballkani
Malisheva - Gjilani

Gjithçka gati për Maratonën 'Prishtina 2024'

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Tashmë gjithçka është gati për maratonën dhe gjysmëmaratonën 'Prishtina 2024', e cila këtë herë do të mbahet më 22 shtator në Prishtinë. Federata Atletike e Kosovës do të organizojë këtë ngjarje të madhe sportive me moton "Vrapo pa kufi". Drejtuesit e Federatës, Këshillit Organizativ dhe komunës së Prishtinës kanë dhënë hollësi, duke thënë se regjistrimi deri më tani ka kaluar numrin 500, duke bërë një rritje prej edicioneve me pjesëmarrjen më të madhe



ndonjëherë. Arsye për këtë, sipas kryetarit të FAK-ut, është edhe rritja e vlerës së shpërblimeve. Risi është edhe pjesëmarrja e kampiones së Evropës në 3000

metra me pengesa, Luiza Gega, e cila do të vrapojë në disiplinën 42 kilometra. Regjistrimi do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, derisa iu bë thirrje edhe qytetarëve të Kosovës të regjistrohen dhe t'i bashkohen maratonës, qoftë në disiplinën dykilometërshë, qoftë në ato 5 km, apo edhe në 10, 21 dhe 42 kilometra. Sipas Kushtrim Mushicës, drejtor i sportit në komunën e Prishtinës, ngjarja zhvillohet edhe në kuadër të epitetit që ka marrë kryeqyteti këtë vit "Prishtina, qytet evropian i sportit".

Trepça mposhtet nga kampioni i Çekisë

Mitrovicë, 20 shtator - Kampionia e Kosovës, Trepça, është mposhtur nga kampioni i Çekisë, Nymburk. Mitrovicasit pësuan me rezultat 84:78 (20:17, 20:18, 21:19, 23:24). Sfida u zhvillua në Anatalia, në kuadër të gjysmëfinales kualifikuese për Ligën e Kampionëve. "Xehetarët" luftuan deri në fund dhe pasi kishin fituar çerekfinalen ndaj kampionit të Qipros, shpresuan se do të jenë pjesë për herë të parë pjesë e grupeve të Ligës së Kampionëve. Pjesa e parë ishte e baraspeshuar, duke përfunduar 40:35 për çekët, derisa



mitrovicasit tentuan rikthimin në pjesën e dytë, por nuk ia arritën qëllimit dhe pësuan 84:78. Kjo ishte hera e parë që Trepça luajti në kualifikimet e Ligës së Kampionëve, derisa tashmë do të luajë në FIBA Europe Cup në edicionin e ri.


Rashica largohet nga KB Prishtina, vazhdon karrierën në Turqi

Prishtinë, 20 shtator - Ish-trajneri dhe ish-asistenti i Klubit të Basketbollit Prishtina, Andin Rashica, është larguar nga klubi i kryeqytetit. Rashica, i cili me KB Prishtinën fitoi 27 trofe, karrierën do ta vazhdojë

te skuadra turke, Manisa Basket, e cila garon në Superligën e Turqisë si dhe në FIBA Champions League. "Falënderojmë Rashicën për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për klubin për më

shumë se një dekadë, teksa me krenari ju njoftojmë se ai ka bërë një hap para në karrierë duke u angazhuar si ndihmëstrajner i parë në skuadrën turke Manisa Basket e cila garon në Superligën Turke

dhe në FIBA Champions League. Dino me Prishtinën ka fituar plot 27 trofe, ndër to si kryetrajner fitoi dy: Kupën dhe Superkupën me përbërje 100 % vendore", thuhet në njoftimin KB Prishtinës.



Vdes kryetarja e Federatës së Peshëngritjes, Shirin Hyseini

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Në moshën 84-vjeçare ka vdekur kryetarja e Federatës së Peshëngritjes së Kosovës, Shirin Hyseini. Hyseini ka dhënë kontribut të madh në zhvillimin e sportit të Kosovës derisa ka qenë edhe themeluese e Federatës së Peshëngritjes së Kosovës. Presidenti i Komiteti Olimpik

i Kosovës, Ismet Krasniqi, e ka ngushëlluar familjen Hyseini. "Me pikëllim të thellë pranuar lajmin për ndarjen nga jeta të Shirin Hyseini, kryetare e Federatës së Peshëngritjes së Kosovës. Hyseini ishte njëra prej themelueseve të kësaj federate, por njëkohësisht dha kontribut të çmuar edhe

në sporte tjera. Ajo një kohë ishte edhe kryetare e Klubit të Basketbollit Universiteti Femrat në kohët e arta të klubit prishtinas, por edhe basketbollit të Kosovës. Vdekja e saj në moshën 84-vjeçare do të lë boshllëk në sportin tonë, e veçanërisht tek vajzat, për të cilat ishte inspirim se si me punë dhe

përkushtim arrihen sukseset. Në emër të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, dhe lëvizjes olimpikë në vend, i shpreh ngushëllimet më të thella familjes së tij, Federatës së Peshëngritjes së Kosovës, miqve dhe dashamirësve të sportit", thuhet në telegram ngushëllimin e kryetarit të KOK-ut.



Rahoveci kërkon fitoren e dytë, Besa Famgas të parën

VUSHTRRI, 20 SHTATOR - Me ndeshjen Vushtrria - Rahoveci fillon xhiron e dytë të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Kjo ndeshje zhvillohet të shtunën nga ora 20:00 në palestrën "Jeton Tërstena - Tota" në Vushtri. Kampioni Rahoveci vlerësohet favoriti i madh. Të hënën Rahoveci fitoi derbin ndaj Besa Famgasit dhe tani e kërkon fitoren e dytë. Fitore në xhiron e parë shënoi edhe Vushtrria ndaj Trepçës në Mitrovicë. Të dielën prej orës 17:00 është ndeshja Trepça - Vjosa. Skuadra nga Shtimja zhvillon ndeshjen e parë pas kthimit në elitë dhe synon dy pikë në Mitrovicë. Të hënën është ndeshja në mes të Prishtinës dhe Besa Famgasit. Fillon në orën 19:00.

Prishtina, pas fitores ndaj Llapit, synon ta befasojë Besën, por skuadra pejane udhëton drejt kryeqendrës për t'i fituar dy pikët e para. Shpresohet në ndeshje interesante. Ndeshja në mes të



Kastriotit dhe Llapit është shtyrë për shkak të ndeshjes evropiane të skuadrës ferizajase. Xhiron e dytë sjell derbin e radhës në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Të dielën nga ora 18:00 përballen Istogu dhe Samadrexha, dy prej skuadrave që synojnë kreun e tabelës. Për Samadrexhën është ndeshja e parë e edicionit, ndërsa kampioni Istogu kërkon të reagojë pas humbjes nga Ferizaj në xhiron e parë. Për të dyja

skuadrat është test i rëndësishëm pak javë para sfidave evropiane. Të dielën nga ora 18:00 është edhe ndeshja në mes të Prishtinës dhe Besës. Edhe kjo ndeshje pritet të jetë interesante. Dy ndeshje të tjera të xhiros së dytë janë të shtunën nga ora 17:00. Ferizaj e pret Vushtrrinë, kurse Verona takohet me Shqiponjën. Ferizaj vlerësohet favoriti, por edhe vushtrriasit udhëtojnë me shpresë për sukses në qytetin me traditë të hendbollit.

De Rossi: Nuk do të kthehem më kurrë te Roma

ROMË, 20 QERSHOR - Daniele De Rossi nuk është më trajner i Romës. Kanë kaluar dy ditë nga njoftimi për shtyp, i cili zyrtarisht shënoi fundin e aventurës së ish-mesfushorit në bankinën e klubit verdhekuq. Një vendim i papritur, i cili mbërriti te De Rossi gojarisht nga CEO, Lina Souloukou, teksa trajneri ndodhej në "Trigoria" duke u përgatitur për stërvitje. Një kthesë e papritur, që solli Ivan Juriq në bankinën verdhekuqe, me trajnerin kroat të paralajmëruar se çfarë fati e pret pa rezultatet e duhura, mjafton të shikojë si përfunduan Mourinho dhe De Rossi, dy më të fundit në drejtimin e Romës.

Njoftimi i lamtumirës së De Rossit la pashmangshmërisht disa pasoja, siç dëshmohej prej protestave mospajtuese nga tifozët, të cilët shprehën zhgënjimin e tyre për vendimin, duke mbështetur



plotësisht ish-mesfushorin. Vendimi që iu komunikua nga Lina Souloukou tronditi edhe vetë De Rossin, i cili kishte shqiptuar një fjali, që askush në "Trigoria" nuk do të kishte dashur ta dëgjonte. Siç raporton "Corriere dello Sport", ish-mesfushori kishte thënë: "Pas kësaj here nuk do të kthehem më kurrë te Roma...". Një fjali e shqiptuar me një 'gungë në fyt', ndërsa zbrazti

dollapin dhe foli me punonjësit e klubit të pranishëm. Pas rinovimit të nënshkruar qershorin e kaluar dhe fjalëve për një projekt afatgjatë, De Rossi priste një konsideratë ndryshe nga klubi, si për punën e kryer, ashtu edhe nga investimi i bërë në merkato. "Nuk mund të ishim më të lumtur se të ndërtonim një projekt afatgjatë me Daniele", thuhet në shënimin zyrtar të rinovimit në qershor, i cili megjithatë nuk u ndoq nga faktet. Marrëdhëniet e tensionuara me drejtorin sportiv Ghisolfi dhe prurjet e munguara të En-Nesyri, Bade dhe Tiago Djalo u pasuan me tension në dhomat e zhveshjes, me episodin e përplasjes me Cristante. Faktorë që, shtuar vetëm tri pikët e grumbulluara në katër ndeshjet e para të kampionatit, çuan në kthesën e papritur dhe vendimin për ta shkarkuar De Rossin si dhe për ta ndryshuar kursin.

SHKURT

Ylber Ramadani, ndër lojtarët që ka vrapuar më shumë në 'Euro 2024'

Ylber Ramadani është pa dyshim "maratonomaku" i skuadrës kombëtare të Shqipërisë. Mesfushori kuqezi është një prej lojtarëve që vërteton potencialin që ai ka në çdo ndeshje që luan me Shqipërinë. Ndoshta kjo është edhe një nga arsytet se pse trajneri Sylvinho e ka kthyer në një pikë referimi dhe në një lojtar të pazëvendësueshëm për ekipin kombëtar. Në raportin e fundit teknik të skuadrave pjesëmarrëse në "Euro 2024", të publikuar nga UEFA, Ylber Ramadani është një nga futbollistët që ka përshkruar më shumë kilometra në fushë në ndeshjet e zhvilluara me Shqipërinë në "Euro 2024". Ramadani ka një mesatare prej 12.51 km për ndeshje dhe është renditur i pesti në klasifikimin e lojtarëve që ka vrapuar më shumë në fushë. Djaloshi shqiptar ka lënë pas emra të mëdhenj të futbollit evropian si Granit Xhaka, Declan Rice, Joshua Kimmich, Tomas Soucek dhe Giorgi Kochorashvili.

Formacioni i javës së parë në Ligën e Kampionëve

Të enjten përfundoi java e parë e formatit të ri në Ligën e Kampionëve për sezonin 2024-2025. Faqja e njohur e statistikave "Sofascore" ka publikuar formacionin e javës. Në këtë 11-she me notën më të lartë është sulmuesi i Bayern Munchenit, Harry Kane (10), i cili shënoi katër gola në fitoren e skuadrës së tij 9-2 ndaj Dinamo Zagrebit. Në formacion janë edhe tre lojtarë të tjerë të Bayernit: Jamal Musiala, Olise dhe Joshua Kimich. Formacioni: Ryznik, Gvardiol, Scales, Schlotterbeck, Kimmich, Engels, Olise, Musiala, Gismann, Wirtz, Kane.

Joshua nuk mendon për pensionim

Ish-kampioni i botës në peshat e rënda, Anthony Joshua, ka zbuluar se do të tërhiqet nga boksi vetëm nëse nuk e ka mentalitetin për të vazhduar. AJ do të përpikët të bëhet tri herë kampion bote të shtunën e ardhshme kur do të përballet me Daniel Dubois në peshat e rënda të Federatës Ndërkombëtare të Boksit (IBF).

"Shumë", u përgjigj Joshua kur u pyet se sa vite i kanë mbetur në karrierën e tij në boksi. Në moshën 34-vjeçare Joshua ka ende shumë luftime përpara tij, por nëse vendos të lërë boksin, thotë se kjo do të varet nga forca e tij mendore dhe jo nga gjendja e tij fizike. "Nuk është aspekti fizik, jam i fortë si dem, jam mirë. Unë jam në formë, shumë në formë", ka shtuar Joshua. "Unë bëj shumë sport, ndoshta jam duke luftuar më shumë se kur isha kampion, kështu që po përpikem më shumë. Është vetëm se nëse jam i uritur mendërisht për ta bërë këtë, për sa kohë do të jem mendërisht gati për të shkruar në betejë", ka deklaruar Joshua.

Flick: Do të zhvillojmë një Ligë të Kampionëve të mirë

Barcelona pësoi humbje nga Monaco (2-1) në ndeshjen e parë të këtij edicioni në Ligën e Kampionëve. Trajneri Hansi Flick ka thënë se ndikim në këtë ndeshje pati kartoni i kuq

që e mori Eric Garcia pas dhjetë minutash lojë. Megjithatë trajneri gjerman është i bindur se Barcelona do të bëjë një Ligë të Kampionëve të mirë në këtë edicion.

"Ndeshja ndryshoi pas kartonit të kuq në minutën e 10. Pas këtij momenti ndryshoi ideja jonë, ajo që kishim planifikuar. Ne e provuam në çdo formë, u mbrojtëm me pasion, por

bëmë edhe disa gabime. Nuk luajtëm në nivelin tonë maksimal, ashtu si në dëshirojmë të luajmë. Sigurisht kur të rikthehen edhe lojtarët e tjerë do të jemi më të fortë.

Jemi të sigurt se mund të bëjmë një Ligë të Kampionëve të mirë këtë sezon. Mungojnë edhe 7 ndeshje të tjera për ta arritur objektivin tonë", ka thënë Flick.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 20.09.2024 të rishpall:

KONKURS

Një (1) Inkasant- Njësia në Skenderaj, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 350.00 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bëne zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të përgjithshme;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të dretpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurtë, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtja të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 20.09.2024 deri me 05.10.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmiteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gazmen Kadriaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizreni.

- Luan Berisha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizreni.

- Nadire Mehmeti nga Skenderaji shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Alban Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari".

- Zana Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

